

URDHËR
Nr. 219, datë 11.1.2016

**PËR MIRATIMIN E KONTRATAVE “TIP” TË SHËRBIMIT QË LIDHEN MIDIS
SHOQËRIVE PËRMBARIMORE /PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË DHE
PALËVE TË INTERESUARA, PËRPARA FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË
EKZEKUTIMIT PËRMBARIMOR**

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102, të Kushtetutës, shkronjës “dh”, të nenit 10, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, si dhe të paragrafit 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizmin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me propozim të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kontratës “Tip” të shërbimit që lidhet midis shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit përmbarimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e kontratës së shërbimit që lidhet midis shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit përmbarimor dhe institucioneve shtetërore apo personave të tjerë fizikë ose juridikë të përjashtuar nga detyrimi për parapagimin e tarifës përmbarimore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet shoqëria përmbarimore/ përmbaruesit gjyqësorë privatë që të lidhin kontratat individuale të shërbimit, sipas dy formateve të kontratës “Tip” bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani